



01.Nr. 146/10  
Më: 24.06.2010

## PROCESVERBAL

### Nga mbledhja e VI-të (V-të për v. 2010) e Kuvendit Komunal në Vushtrri mbajtur më 27.5. 2010

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:15**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri, përveç Besim Jasharit, Nysret Gërxhaliut, Zeqir Hasanit. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë.

**Ferit Idrizi-** propozoi që të heqet pika nr. 9 e rendit të ditës, pasi që mungon Kryetari i Komunës, dhe të debatohet në seancën e radhës, kur do të jetë prezent edhe Kryetari i Komunës, kurse në vend të pikës 9 të rendit të ditës, propozoi që të futet “Propozimvendimi për shpalljen e tenderit për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të pronës së paluajtshme të Komunës”.

**Refik Ramaj-** paraqiti vërejtje që në rendin e ditës nuk janë përfshirë disa kërkesa të grupit asambleist të LDK-së që disa prej tyre kanë qenë me rëndësi të madhe për t’u debatuar në Kuvendin e Komunës, siç janë: pasqyrat financiare për vitin 2008, plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorëve, gjithashtu edhe disa kërkesa tjera që i kanë paraqitur, dhe vërejtjet që i kanë dhënë për raportet lidhur me formën dhe përmbajtjen e raporteve, tha se prap vazhdohet me avazin e vjetër, prandaj si grup asambleist i LDK-së ndihemi të injoruar dhe në shenjë proteste bëjmë një reaksion demokratik dhe në këtë seancë kemi vendosur që të mos marrim pjesë as në diskutime, as në votime, por vetëm do të jemi vëzhgues të qetë.

**Ferit Idrizi-** tha se çdo vendim që e merr një grup asambleist, na e respektojmë, përkundër dëshirës që të jeni pjesë e angazhimit dhe pjesë e kontributit në këtë seancë.

**Qazim Azemi-** pasi që një pjesë e ekzekutivit mungon dhe Kryetari i Komunës mungon me arsye, propozoi që kjo mbledhje të shtyhet për një ditë tjetër, sepse Kuvendi pa kreun është problem, pasi që kemi shumë pika që kryesisht lidhen me Kryetarin. Pastaj paraqiti vërejtje lidhur me pyetjet që kanë bërë, ose nuk kanë ardhur përgjigjet e plota, ose nuk kanë ardhur fare, dhe përmendi rastin që i kanë bërë pyetjet me shkrim në emër të grupit asambleist të AAK-së, vetëm për një kemi

marrë përgjigje, ndërsa për 3 pyetje tjera nuk kemi marrë përgjigje, që kanë kërkuar nga Kryetari i Komunës.

**Sami Istrefi-** grupi asambleist i PDK-së përkrahë rendin e ditës, dhe u pajtua për disa kërkesa që i paraqiti shefi i grupit asambleist të LDK-së, për të cilat është dashtë të ketë përgjigje, pasi që kanë një rëndësi të veçantë. Sa i përket propozimit nga AAK-ja që të shtyhet seanca, tha se nuk ka arsye që për këtë të shtyhet seanca, pasi që shumica e anëtarëve të qeverisë lokale janë prezent, poashtu seancën e kryeson Kryesuesi i Kuvendit, ka kuorum të mjaftueshëm, prandaj propozoi që e njëjta të zhvillohet punimet ashtu siç është rendi i ditës.

**Ferit Idrizi-** tha se në sistemet demokratike parlamentare legjislativi është i ndarë nga ekzekutivi, prandaj mos të krijojmë varshmëri. Pastaj prezenca e Kryetarit të Komunës nevojitet atëherë kur na kemi ballafaqim me të dhe kur ka për të paraqitur raport, poashtu e kemi prezencën e shumicës së drejtorëve. Prandaj të gjitha kushtet janë të plotësuar për fillimin dhe vazhdimin e seancës së Kuvendit.

**Qazim Azemi-** propozoi që në rend dite të shtohet edhe pika për të cilën kanë kërkuar përgjigje, por nuk ka ardhur e plotë, por gjysmake, duke përmendur rastin për arsim lidhur me emërimin dhe rrimërimin e drejtorëve, pasi që i kemi 32 institucione, kurse përgjigjeja ka ardhur vetëm për 10 shkolla, dhe mungon ajo që kanë kërkuar, pra kualifikimi, përgatitja shkollore, prandaj propozoi që kjo çështje të hyn në rend dite, pra rreth emërimit dhe rrimërimin të drejtorëve në shkollat e mesme të larta, shkollat e mesme të ulta dhe shkollat fillore.

**Muharrem Shabani-** tha se ne si grup asambleist i AAK-së kemi kërkuar dhe kërkojmë që të bëhet transmetimi i këtyre mbledhjeve edhe publikisht. Pastaj çështjet që vet i kemi aprovuar në programin e punës, po i shkelim, dhe përmendi si rast temat që janë paraparë për muajin maj, e që nuk janë në rend dite, siç janë Projektregullorja për organizimin e punës dhe mësimin në shkolla fillore në Komunën e Vushtrrisë. Poashtu tha se për Stanoc është marrë vendim me 31.07.2008, dhe e lexoi përmbajtjen e vendimit në fjalë, duke shtuar se pse nuk janë zbatuar procedurat, pse duhet përsëritur vendimi, është çështje në vete. Prandaj na kemi kërkuar Informatë për shumë çështje të ngjashme, por nuk kemi marrë asgjë me shkrim. Në fund e mbështeti kërkesën e Q.Azemit që prezenca e Kryetarit të Komunës është e nevojshme, pasi që ai e ka përgjegjësinë për ekzekutimin e vendimeve.

**Ferit Idrizi-** me propozimin që e paraqiti në fillim të seancës Kryesuesi i Kuvendit dhe propozimin e dhënë nga Qazim Azemi, e qiti për aprovim rendin e ditës.

**Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 20 vota "për" , të tjerët "abstenim" , aprovoi këtë:**

## **R E N D I T E**

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e Kuvendit të Komunës.**
- 2. Shqyrtimi Informatës për të hyrat buxhetore për muajin prill 2010.**
- 3. Shqyrtimi Projektregullores për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve (shqyrtimi i dytë).**
- 4. Shqyrtimi Propozimvendimit për ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba komunale.**
- 5. Shqyrtimi i propozimvendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të tokës ndërtimore në ZK-le Smrekonicë, Pestovë dhe Lumëmadh.**

6. **Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për**
  - a. **Rritje të vlerës së projektit “Asfaltimi i rrugës në fsh. Stanoc i Epërm, lagja “Shala...”, për 68.014.00 €;**
  - b. **Ridestnimi i mjeteve në shumë prej 7.000.00 € për blerje të aparatit fotokopjues për Sekretarinë e KK-së.**
7. **Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen e mjedisit në Komunën e Vushtrrisë.**
8. **Miratimi i vendimit për ndarje të plaketa-mirënjohjeve për nderë të ditës së çlirimit të Vushtrrisë. (dorëzimi solemn i tyre do të bëhet më 17 qershor 2010).**
9. **Shqyrtimi i Propozimvendimit për shpalljen e tenderit për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës.**
10. **Të ndryshme:**
  - a. **Shkyçjet kolektive nga rrjeti elektrik në Komunën e Vushtrrisë.**
  - b. **Emërimi dhe riemërimi i drejtorëve në shkollat e mesme të larta, shkollat e mesme të ulta dhe shkollat fillore.**
  - c. **Pyetjet e ndryshme të anëtarëve të Kuvendit.**

## **1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e Kuvendit të Komunës.**

**Edhe pse nuk kishte vërjetje për ndonjë mangësi në procesverbal, në këtë pikë të rendit të ditës paraqiti këtë qëndrim:**

**Muharrem Shabani-** në pjesën e diskutimit të tij, faqe 2, tha se ka kërkuar dhe përsëri mbetet pas asaj kërkesë që të gjendet formë për angazhimin e transparencës më të plotë të një televizioni lokal apo tjetër, që në formën ligjore bëhet përcjellja e mbledhjeve, por nuk ka kurrfarë deklarimi rreth kësaj nga organet kompetente të Komunës sonë. Poashtu lidhur me vërshimet në Komunën tonë, tha se është ndërmarr një aktivitet dhe thuhet se është një kërkesë e cila iu është drejtuar Ministrisë së Bujqësisë, mirëpo sipas gjasave kemi 70 fermerë të dëmtuar, duke shtuar se nuk është bërë një qasje serioze, dhe tha se qëllimi nuk duhet të jetë vetëm regjistrimi i këtyre pronave, por si mundemi për t’u ndihmuar këtyre qytetarëve, dhe kërkoi që të gjendet forma nga Komuna e Vushtrrisë për marrjen shitesë të masave për kompensim, ose tek ujitja, ose diçka tjetër që të bëhet ndonjë subvencionim.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Aprovohet procesverbali i mbledhjes së fundit të Kuvendit të Komunës, me 26 vota “për” , kurse të tjerët “abstenim”.***

## **2. Shqyrtimi Informatës për të hyrat buxhetore për muajin prill 2010.**

**Tasim Gubetini-** tha se është brengosëse nëse krahasohet muaji prill 2009 me muajin prill 2010, inkasimet janë të përafërta (të njëjta), por është dashur me qenë inkasimet së paku për 1 % më të mëdha se vitin e kaluar, duke pyetur drjetorin e buxhetit se ku janë të metat e inkasimit?

**Pajazit Pllana-** paraqiti vërejtje lidhur me pjesëmarrjen në nivelin e mjekësisë primare, e cila është 68 %, pra ka një rënie, duke shtuar se vjelja duhet të komentohet, arsyetohet dhe të jepet një vlerësim profesional nga QKMF-ja, dhe si problem kompleks të arsyetohet se rrethanat janë të rënda.

**Muharrem Shabani-** tha se këtë material ka nevojë që ta shqyrton vet drejtorja, sepse shifrat, përqindjet dhe indekset nuk përputhen, dhe janë të dhëna gabimisht, duke njoftuar se si grup asambleist nuk do ta votojnë me këto gabime.

**Isuf Jashari-** sa i përket pyetjes së T.Gubetinit, u përgjigj se inkasimi ndryshon nga muaji në muaj, duke njoftuar se ka qenë një vonesë nga ana e PTK-së në shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë, kurse në muajt e ardhshëm do të ketë një rritje shumë më të madhe. Sa i përket vërejtjes së M.Shabanit, kërkoi nga ai që konkretisht të tregojë ku nuk janë në rregull, në cilin pozicion, në cilën pikë, sepse në bazë të qarkores buxhetore, nëse është limiti i të hyrave i caktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, dhe nëse bëhet planifikimi, atëherë çdo herë realizimi do të jetë më i madh se vlera e caktuar e limitit të të hyrave.

**Tasim Gubetini-** pyeti se sa Komuna i paguan PTK-së për shpërndarje të faturave?

**Isuf Jashari-** u përgjigj se kjo është marrëveshje në mes të ministrisë dhe PTK-së.

### **3. Shqyrtimi Projektregullores për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve (shqyrtimi i dytë).**

**Sabit Kadriu-** kërkoi që rregullorja në fjalë të zbatohet me përpikëri, sepse në disa raste në ndërtimin e objekteve nuk janë respektuar rregulloret, dhe ka pasur etazhe të cilat kanë rënë në kundërshtim me projektin që e kanë dorëzuar për aprovim në Kuvendin Komunal.

**Sami Istrefi-** propozoi që në nenin 36.1 nën pikën 3, edhe pse Ligji mbi Ndërtimin nuk e specifikon që duhet një projekt i tillë, por nëse e parasheh ndonjë ligj i posaçëm, atëherë është mirë të specifikohet në këtë rregullore, apo ndonjë udhëzim administrativ nga organi kompetent.

**Idriz Ismajli-** sa i përket propozimit të S.Istrefit, tha se projekti për objektet e veçanta në bazë të Ligjit mbi ndërtimin është alineja 2 që parasheh mbrojtjen nga zjarri.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 20 vota “për”, të tjerët “abstenim” , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:  
*Aprovohet Projektregullorja në fjalë në bazë të propozimeve të diskutuesve.***

### **4. Shqyrtimi Propozimvendimit për ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale.**

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 20 vota “për”, të tjerët “abstenim” , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:  
*Aprovohet Propozimvendimi në fjalë.***

### **5. Shqyrtimi i Propozimvendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të tokës ndërtimore në ZK-le Smrekonicë, Pestovë dhe Lumëmadh.**

**Esat Beka-** kërkoi që në fshatin Smrekonicë të gjendet një hapësirë tjetër, e jo në hapësirën e shkollës fillore, pasi që qytetarët do të kenë lëvizje në oborrin e shkollës duke pasur kontakte me nxënësit.

**Nezir Klinaku-** tha se PTK-ja e ka bërë kërkesën për ato vende që janë të paraqitura në propozimvendime, dhe mund të ndahet në një qoshe të oborrit të shkollës.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për”, të tjerët “abstenim” , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:  
*Aprovohet Propozimvendimi në fjalë.***

### **6. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për**

**a. Rritje të vlerës së projektit “Asfaltimi i rrugës në fsh. Stanoc i Epërm, lagjeja “Shala...”, për 68.014.00 €;**

**b. Ridestnimi i mjeteve në shumë prej 7.000.00 € për blerje të aparatit fotokopjues për Sekretarinë e KK-së.**

**Muharrem Shabani-** tha se kjo formë edhe në arsyetim paraqet diçka që nuk ka lidhje me administratën dhe pushtetin, sepse është dashur të jetë një propozimvendim për shtimin e këtyre mjeteve me arsyeime konkrete. Prandaj është dashur të vjen një propozim prej drejtorit, i rekomanduar prej Kryetarit të Komunës dhe ta ketë formën e vet të duhur. Pra, është dashur të vjen si propozimvendim, e jo si kërkesë.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 20 vota “për”, të tjerët “abstenim”, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:  
*Aprovohet Kërkesa në fjalë duke inkorporuar edhe vërejtjen e anëtarit të Kuvendit.***

## **7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen e ambientit në Komunën e Vushtrrisë.**

**Bahrije Pllana-** tha se drejtori në fjalë ka bërë një Informatë vetëm për gjendjen në qytet dhe për punët që janë ndërmarrë në qytet, duke mos i përfshirë edhe fshatrat, prandaj ka qenë mirë për të na informuar edhe për gjendjen nëpër fshatra, duke shtuar se mungojnë rrjetet e kanalizimit, në çdo fshat ka shumë deponi të mbeturinave, që askush nuk i menaxhon. Pastaj vendosja e kontejnerëve nëpër qytet është në vende joadekuate, duke përmendur si rast konkret para çerdhes së fëmijëve, para Kalasë, duke propozuar që në qytet të hiqen tërë kontejnerët, dhe të furnizohen qytetarët me qese të zeza dhe në kohën e caktuar me i qit qeset qytetarët dhe kompania që menaxhon mbeturinat me i mbledhë ato.

**Sami Istrefi-** tha se kjo Informatë ka ardhur nga drejtori I.Ismajli, por nuk është kompetencë e tij, pasi që kjo kompetencë i takon Drejtorisë për Shërbime Publike. Në vazhdim përmendi rezultatet e punës së bordit të ri. Pastaj tha se menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë nuk është i kënaqshëm, prandaj propozoi që të nxjerret një rekomandim si Kuvend dhe të obligohet Drejtoria për Shërbime Publike që në bashkëpunim me anëtarin e bordit, dhe me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, dhe ndërmarrjen “Uniteti” që të rrisin performancën e rritjes së të hyrave, pasi që të hyrat në këtë ndërmarrje janë shumë të ulta, deri në 28 % .

**Islam Krasniqi-** tha se fshati Maxhunaj është në gjendje të mjerueshme sa i përket kanalizimit, pasi që KFOR-i ka një territor të madh, dhe të gjitha shirat që grumbullohen në atë pjesë e kanë shkatërruar një rrugë e cila është bërë rrugë e pakalueshme, duke kërkuar nga Komuna që të bëhet shtruarja e gypave.

**Sabit Kadriu-** tha se çështja e ambientit nuk është vetëm problem komunal dhe shtetëror, por është problem edhe ndërshtetëror, pasi që shumë vende të botës problemin më parësor e kanë vendos çështjen e ambientit. Në vazhdim tha se ne jemi të mbytur prej mbeturinave, pasi që në çdo vend ka mbeturina, por kohëve të fundit nëpër institucione shkollore janë ndërmarrë disa aktivitete nga drejtorët e shkollave dhe është bërë pastrimi i ambientit, dhe ky pastrim i oborreve të shkollave ndikon për të mirë në mjedisin e përgjithshëm të qytetit, mirëpo sa i përket rrugëve të qytetit, nuk e kemi punën mirë sikur me ujërat e zeza, ashtu edhe sa i përket mbajtjes pastër të rrugëve të qytetit. Mandej propozoi që të shpallet një konkurs dhe shkollat, institucionet (fabrikat) që kanë ambientin më të mirë të shpërblehen. Gjithashtu kaosi urbanistik ka shkaktuar edhe kaos në çështjen e infrastrukturës së rrugëve, në çështjen e pastërtisë.

**Qazim Azemi-** tha se mbrojtja e ambientit secilin qytetar duhet ta preukopoj. Pastaj e përhëndeti sheshin që është hapur, në të cilin kanë qenë të vendosur taksistët, kurse drunjët dekorativ janë shumë të mirë, mirëpo nuk po mirëmbahen sa duhet,

duke propozuar që ta kemi një projektregullore të veçantë lidhur me mbrojtjen e ambientit, të bashkëpunohet me ambientalistët.

**Tasim Gubetini-** tha se Informata në fjalë është paraqitur nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit, mirëpo menaxhimi i mbeturinave i përket Drejtorisë për Shërbime Publike, por të dy drejtoritë nuk kanë një person profesional që do të merret me projekte për ujëra të zeza dhe menaxhim të mbeturinave, dhe propozoi që brenda këtyre dy drejtorive të inkuadrohet një punëtor profesional, një ekolog që do të merret me projektimin dhe menaxhimin e këtyre mbeturinave dhe ujërave të zeza.

**Muharrem Shabani-** tha që kjo çështje e inicuar nga V.Karaça do të ishte hendikep pa angazhimin e tyre dhe pa vizonin e tyre që të nxirren përfundime të veçanta, dhe kishte qenë mirë që përsëri në mbledhjen e radhës të rishqyrtohet. Pastaj tha se kjo tematikë është e gjërë dhe nuk është i vetëm një drejtorie, por duhet të bëhet një plan i koordinuar i shumë drejtorive: Drejtorisë për Urbanizëm, Shërbime Publike, Drejtorisë së Shëndetësisë, të Arsimit, të Bujqësisë, të Inspeksionit, Agjencionit të veterinarëve, dhe enteve të ndryshme, pasi që është e nevojshme në këtë fazë një koordinim i veçantë, sepse në Komunën tonë kemi disa lajme të rënda pasi që kemi paraqitjen e disa sëmundjeve të rënda siç janë: tularemia, bruceloza, pastaj në qytet është sëmundja e barkqitjes, prandaj të gjitha këto vijnë nga shkaqe të arsyeve të ndryshme, qoftë nga uji që nuk po vjen me kohë, pra po ndalet me distanca kohore të ndryshme, prandaj administratës nga ky Kuvend t'i ipet detyrë e posaçme në këtë drejtim. Poashtu kërkoi që ky Kuvend të informohet mbi funksionimin e ndërmarrjeve publike, të kemi një Informatë kush dhe si është bërë zgjedhja e anëtarëve në bordet ekzekutive në ndërmarrjet publike, sepse ajo duhet të zbatohet konform dispozitave të ligjit dhe autorizimeve të këtij Kuvendi. Në fund kërkoi që nëse mobilizohen këto drejtori, për mbledhjen e ardhshme të kemi një raport mbi gjendjen e tërësishme.

**Pajazit Pllana-** pyeti se a ka Komuna e Vushtrrisë në kuadër të ujësjellësit gypa të azbestit?

## **8. Miratimi i vendimit për ndarje të plaketave-mirënjohjeve për nder të ditës së çlirimit të Vushtrrisë. (dorëzimi solemn i tyre do të bëhet më 17 qershor 2010).**

**Ferit Idrizi-** propozoi që Kuvendi ta formon një komision dhe bashkarisht të vendosin për ndarjen e mirënjohjeve.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 25 vota "për", të tjerët "abstenim" , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Aprovohet vendimi në fjalë, duke caktuar këta anëtarë të komisionit:***

***Gani Imeri, Habib Mustafa, Melihate Basholli, Sabri Ferati, Remzije Isufi.***

## **9. Shqyrtimi i Propozimvendimit për shpalljen e tenderit për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës.**

**Muharrem Shabani-** tha se lidhur me pronën në fjalë kemi marrë vendim me 31.07.2008, dhe për një sipërfaqe prej 40 ari, e njëjta parcel nr. 412, Komuna Kadastrale Stanoc i Poshtëm, prandaj tani ndryshimi i saj dhe mosbazueshmëria në dispozita ligjore e hyrjes së këtij vendimi, dhe mos thirrja askund në dispozitat mbi Ligjin e tokës bujqësore, sepse ajo duhet të mbrohet, por në ndërkohë po shihet se kemi projekte dhe plane të veçanta për mbrojtje. Prandaj ndarja e 2 hektarëve për këtë qëllim pa dije dhe shndërrimi i një toke të këtillë në tokë ndërtimore që është e një klasi të vlefshëm, kur me Ligjin mbi tokën bujqësore dihet se çfarë procedura kërkohen për ndryshimin e destinimit të tokës. Në vazhdim tha se grupi asambleist i

AAK-së pajtohet që një pjesë e saj, pasi që është marrë vendimi më herët, të mbetet ai vendim, duke kërkuar që një pjesë e vendimit të heqet, sepse 1.60 hektarë të kthehen menjëherë në tokë ndërtimore nga toka nën sistemin e ujitjes është mëkat, është dëm i madh.

**Nezir Klinaku-** tha se vendimi është me 27.11.2008 prej këtij Kuvendi, dhe shtoi se nuk janë 40 ari, por janë 470 metra katror. Pastaj këtë që e ka paraqitur tha se është skica, lista poseduese dhe kopja e planit, kurse arsyeja pse janë ndarë këta dy hektarë prej 5.50 hektarëve është se më herët Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrit e ka bërë një kërkesë tek Agjencioni Kosovar i Privatizimit që nëse ata janë të pajtimit për të bërë ndërrimin e pronës, prandaj na nuk mundemi me bërë ndërrimin e pronës me agjencionin në fjalë, përderisa ata nuk kanë kthyer asnjë përgjigje, prandaj e kemi lënë si rezervë 3.50 hektarë, ndërsa 2 hektarë kanë mbet pronë e Komunës. Në fund njoftoi se interesimi i bizneseve është shumë i madh për këtë parcelë.

**Muharrem Shabani-** tha se ka dy vendime, edhe njërin propozim edhe tjetrin, me 27.11.2008 është shqyrtuar 470 metra, dhe të njëjtën parcelë, të njëjtën sipërfaqe, kurse me 31.07.2008 është marrë vendimi tjetër më herët për 40 ari në atë pjesë, parcela kadastrale 412, dhe për këtë kemi kërkuar Informatë me shkrim, për t'i parë ku janë këto vendime, sepse ne nuk i kemi marrë. Në fund tha se pajtohet që të jetë vendimi i 31.07.2008, 40 ari nga kjo parcelë, kurse për pjesën tjetër është kundër ndryshimit të pronës bujqësore në tokë ndërtimore.

**Sami Istrefi-** tha se në bazë të vendimit të nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit me 27.11.2008 dhe shumë mirë precizohet sa metra katror janë dhënë, prandaj si grup asambleist i PDK-së propozojmë që në bazë të propozimvendimit të propozuesit nga Drejtoria e Kadastrit të hudhet në votim.

**Pajazit Pllana-** paraqiti tri pyetje për hartuesin e Propozimvendimit: cili është interesi i Komunës për këtë biznes? Sa gjeneron vende pune? Çka parasheh në planin e zhvillimit hapësinor dhe ruajtjen e ambientit?

**Nezir Klinaku-** tha se nuk është i përcaktuar lloji i biznesit, por ka kërkuar që të shpallet tenderi, për t'u dhënë për biznese kjo pjesë e parcelës, e cila qe 12 vjet shfrytëzohet prej qytetarëve, duke shtuar se kooperativa bujqësore lëshon kontrata për tokën e Komunës.

**Qazim Azemi-** tha se grupi asambleist i AAK-së ka bërë kërkesë me shkrim lidhur me pronën në fjalë, poashtu kërkoi që pa u bërë sqarimet e duhura të mos aprovohet.

**Ferit Idrizi-** tha se të gjitha parakushtet juridike janë që ajo mund të tenderohet, prandaj kërkoi nga anëtarët e Kuvendit që ta votojnë, të shkon në tenderim, t'i përfill procedurat e konkurrencës të tregut të lirë, dhe ato biznese që janë më të shkathta le t'i marrin.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 20 vota "për", të tjerët "abstenim", lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:  
*Aprovohet Propozimvendimi në fjalë.***

## **10. Të ndryshme:**

### **a. Shkycjet kolektive nga rrjeti elektrik në Komunën e Vushtrrisë.**

**Ferit Idrizi-** kërkoi që ky Kuvend të aprovon një kërkesë apo rekomandim që t'iu shkon institucioneve deri tek Qeveria e Kosovës, në mënyrë që të hiqet dorë prej shkycjeve kolektive.

**Sami Istrefi-** tha se edhe në KPF kemi diskutuar gjatë lidhur me këtë çështje, dhe kemi nxjerr një rekomandim që të thirret drejtori rajonal në seancën e Kuvendit të Komunës, pasi që edhe nëse nuk kemi kompetencë, kemi hise, sepse të gjitha zyret që i ka KEK-u në Komunën tonë janë prona të Komunës së Vushtrrisë. Në vazhdim kërkoi që të nxirret një rekomandim nga ky Kuvend që t'i drejtohem i instancave më

të larta duke filluar nga Qeveria e Kosovës, e deri tek niveli rajonal që të mos dëmtohen më qytetarët në mënyrë kolektive, sepse po dëmtohet biznesi i tyre ekonomik, familjar dhe biznesor.

**Pajazit Pllana-** pasi që rryma elektrike nuk është kompetencë e Kuvendit Komunal, por është kompetencë e KEK-ut, lidhet drejtpërdrejt me disa pyetje që nuk mund të anashkalohen, dhe shtoi se shkyçjet kolektive janë të papranueshme sepse destimulohet ai që i kryen obligimet, ndërsa stimulohet ai i cili nuk i kryen obligimet. Kuvendi Komunal i Vushtrrisë ka një obligim human ndaj qytetarëve të vet të shikoi se kush ka mundësi t'i kryej obligimet e harxhimit të energjisë elektrike dhe kush nuk ka mundësi, sepse të gjithë përfituesit e skemës sociale në nivelin e Kuvendit Komunal në Vushtrri kanë benefite, duke e shfrytëzuar energjinë elektrike duke mos paguar, kurse të tjerët që janë në gjendje të rëndë sociale nuk kanë mundësi të paguajnë dhe mbesin borxh, prandaj pyeti se kush e kryen atë borxh dhe kush duhet të kujdeset për ta, pasi që nuk kanë ndihmë, nuk kanë të punësuar dhe nuk ka burime të jetës elementare. Furnizimi me rrymë elektrike në tërësi është më i mirë se sa vitet tjera, por shkyçja kolektive e degradon, prandaj Kuvendi Komunal duhet të nxjerr një rekomandim që me KEK-un të ketë një mirëkuptim dhe të gjejë një zgjidhje që të mos bëhet diskriminim.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, të tjerët “abstenim” , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**  
***Aprovohet rekondmandimi i përbashkët që të mos ketë shkyçje kolektive nga rrjeti elektrik në Komunën e Vushtrrisë.***

#### **b. Emërimi dhe riemërimi i drejtorëve në shkollat e mesme të larta, shkollat e mesme të ulta dhe shkollat fillore.**

**Qerim Selimi-** tha se pyetjet që iu janë drejtuar drejtorisë së tij, iu ka dhënë përgjigje konkrete, duke shtuar se në Informatë për pranimin e drejtorëve të shkollave në dy afatet e fundit përfshihen: emri i drejtorit, kualifikimi profesional, përvoja e punës dhe shkolla në të cilën është bërë pranimi, kurse në vazhdim e lexoi përgjigjen që e ka dhënë me shkrim. Pastaj tha se tërë këta drejtorë janë intervistuar dhe janë të ruajtura të gjitha të dhënat në hollësi për secilin kandidat. Gjithashtu bëri të ditur se për të gjitha afatet ka inspektime nga Ministria e Arsimit dhe zyra rajonale. Në vazhdim tha se në konkursin e fundit kanë qenë 15 vende për drejtorë dhe zëvendës drejtorë, kurse janë zgjedhur 10. Ndërsa në konkursin e parafundit kanë kërkuar 16 vende, por nuk është zgjedhur asnjë, sepse sipas Udhëzimit Administrativ neni 2.6, nëse nuk japim përgjigje brenda 30 ditëve, Komuna ka të drejtë të përsëris konkursin, kurse konkursi është shpall me 28.12.2009.

**Sabit Kadriu-** pyeti se cila është arsyeja që në shkollën fillore “Emin Duraku” në Novolan hapet dhe mbyllet konkursi, pasi që ka staf përbrenda shkollës?

**Qerim Selimi-** u përgjigj se në konkursin e fundit në shkollën në fjalë kanë konkurruar tre kandidatë, por asnjëri prej tyre nuk i ka arritur 50 % të pikëve që të zgjidhet drejtori në atë shkollë.

**Qazim Azemi-** tha se është e vërtetë që nuk kanë Informatë të plotë, pasi që është interes i këtij Kuvendi që ta dijnë kualifikimin dhe procedurën si është bërë emërimi dhe riemërimi. Në vazhdim paraqiti vërejtje për shkollën “Liria” në Stroc, duke shtuar se përsëri nuk është zgjedhur drejtori, edhe pse kanë qenë 2-3 konkurse, pra këtu dyshohet për manipulim, pasi që akoma vazhdohet me ushtrues detyre, poashtu në shkollat e mesme tërë drejtorët dhe zëvendës drejtorët janë zgjedhur përmes një animi politik, mandej në disa shkolla iu vazhdohet mandati disa drejtorëve që iu ka skaduar, dhe përmendi rastin në fshatin Maxhunaj. Prandaj do të ishte në interes edhe të DKA-së që të na sjellë një Informatë të plotë për 32 institucionet shkollore, pasi që ajo që është dhënë si përgjigje nga DKA-ja nuk përmendet kualifikimi, përvoja e plotë dhe përgatitja shkollore e atyre drejtorëve.



**Qerim Selimi-** tha se për çdo konkurs bëhet një tabelë, dhe në tabelë janë të gjitha informatat për secilin kandidatë. Kurse sa i përket shkollës në fshatin Stroc, tha se ka konkurruar Xhafer Berisha, i cila ka ofruar një dorëheqje që e ka dorëzuar me shkrim.

### **c. Pyetjet e ndryshme të anëtarëve të Kuvendit.**

**Pajazit Pllana-** lidhur me rrugën e cila shkon për Pantinë-Frashër-Mitrovicë, pyeti se kur do të bëhet vurja e shenjave të komunikacionit përmes ministrisë, pasi që dy viktima kanë rënë, të gjithë nxënësit e shkollës janë shumë të rrezikuar, sepse rruga është shtruar që 2 vite dhe Komuna e Vushtrrisë e ka për obligim që të kujdeset për qytetarët e vet, poashtu kërkoi që shkollës t'i sigurohet një trotuar.

### **Rekomandim: Të gjitha rrugët që kalojnë nëpër territorin e Vushtrrisë të pajisen me shenja të komunikacionit.**

**Qazim Azemi-** tha se disa pyetje që i kanë bërë në seancën e kaluar, përgjigjet iu kanë ardh gjysmake, ose nuk kanë ardh fare, duke shtuar se nuk kanë marrë përgjigje as arsytim për kërkesën tonë lidhur me kontratën e Komunës me NPH "6 vëllezërit Istrefi", dhe tha se me këtë rast është dëmtuar interesi i Komunës dhe ka konflikt interesi, prandaj duhet të shikohet edhe një herë kjo kontratë. Poashtu përgjigjeja rreth anulimit të riemërimit të shkollës së mesme nuk është e plotë dhe në këtë rast është shkelur ligji. Mandej pyetjen që kanë bërë lidhur me ndërtesat tona, pikja e shkollave të reja, është dhënë një përgjigje shkurtër dhe e përgjithësuar, nuk përmenden shkollat përkatëse dhe nuk ka shkresa që janë informacione dhe kërkesa për MASHT-in, apo për investitorët që i kanë lënë keq këto shkolla. Në vazhdim paraqiti edhe këto pyetje:

1. Në emër të grupit asambleist të AAK-së kërkoi përgjigje me shkrim për ndërtimin në tokat bujqësore, pse po lejohen ndërtimet e shumta mbi tokën bujqësoren të dy krahët e magjistrales për Prishtinë, dhe në shumë lokalitete tjera të Komunës së Vushtrrisë, duke pyetur se a janë nën përcjellje të qeverisë komunale këto ndërtime?
2. Kërkoi informatë me shkrim lidhur me uzurpimet e pronave të Komunës, pasi që ka uzurpime edhe të tokave bujqësore edhe të utrinave, po zvogëlohen dita-ditës edhe tokat e ish-kooperativës, dhe kërkoi që të stopohet kjo dukuri.

**Bahrije Pllana-** tha se në seancën paraprake ka kërkuar informatë me shkrim për qëllimin e vizitës në Turqi, duke shtuar se nuk ka kërkuar informatë vetëm për vete, por është në interes për të gjithë anëtarët e Kuvendit, dhe tha se informatën që e ka marrë nuk është e plotë pasi që nuk janë përmendur shpenzimet, dhe përsëri kërkoi që në seancën e radhës për të gjithë anëtarët e Kuvendit të ketë një informatë të kompletuar me shkrim.

**Muharrem Shabani-** paraqiti këto pyetje dhe kërkesa:

1. Kërkoi informatë se kur do të bëhet shtruarja e pjesës plotësuese në rrugën "Dëshmorët e Kombit", pasi që rruga është në gjendje shumë të keqe.
2. Kërkoi informatë për ndërmarrjet publike, kush janë në borde, kur janë zgjedhur, si janë zgjedhur, a janë zgjedh në baza ligjore apo në baza partiake, politike?
3. Tha se e ka marrë një informatë rreth komasacionit, por për tokë bujqësore ky organ është kompetent të merr vendime, edhe për komisione dëshirojmë të dijmë sa kanë qenë ato vlera, sa kanë qenë ato mjete, të kujt kanë qenë, kush ka qenë në komision dhe kush e ka formuar, prandaj kërkoi informatë.
4. Pasi që po i afrohem 6-mujorit, kërkoi informatë se ku jemi me realizimin e premtimeve sipas projekteve zhvillimore që i kanë dhënë për vitin 2010, duke filluar

edhe në numër që janë 63 projekte, dhe pyeti ku është realizimi i tyre?, duke kërkuar që të futet kjo çështje në rend dite, gjithashtu çështja e ndërmarrjeve publike, se si po funksionojnë ato ndërmarrje.

**Habibe Gërxhaliu-** tha se fëmijët me aftësi të kufizuara janë pjesë e kësaj shoqërie, mirëpo këta fëmijë jetojnë në kushte minimale, dhe bëri të ditur se iu ka ardhur urdhëri që të dalin nga objekti ku është i vendosur HANDIKOS-i dhe nuk dihet ku do të vendosen. Pastaj për këta fëmijë kërkoi nga Drejtoria e Arsimit që të fillon regjistrimin në klasën e parë si pjesë e shoqërisë, edhe aty ku janë fëmijët e shëndoshë, në mënyrë që të ndihen pjesë e kësaj shoqërie, duke propozuar që nëpër klasë të vendosen nga dy fëmijë me aftësi të kufizuara, pasi që e ndiejnë veten më mirë kur e kanë në klasë një fëmijë tjetër me aftësi të kufizuara, poashtu kërkoi trajnim për mësuesit për mënyrën se si duhet edukuar këta fëmijë, dhe përmendi një rast në shkollën e fshatit Nadakoc, me ç'rast nuk e kanë pranuar një fëmijë me aftësi të kufizuara, me arsyetimin që fëmija në fjalë nuk është për shkollë normale. Në fund propozoi që mësuesit që i edukojnë fëmijët me aftësi të kufizuara të stimulohen me pagë më të lartë.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:50.**

**Procesmbajtësi:  
Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Ferit Idrizi**